

# Qyteti i Malmos | mbi shkollën



## PËRMBAJTJA E LËNDËS

Qyteti i Malmos – qytet i diturisë	3
Vlerat themelore të shkollës	4
Kështu drejtohet shkolla	6
Shkolla - hap pas hapi	8
Pamja grafike e shkollës	12
Fushat me përparësi	14
Mbikqyrja	17
Qëllimet brenda fushave me përparësi	18
Nëse doni të dini më tepër	23



# Qyteti i Malmos – qytet i diturisë

Qyteti i Malmos ka kaluar nëpër etapa të ndryshme zhvillimi gjatë historisë së tij, duke u transformuar nga një qytet tregtar në fillimet e tij, në një qytet industrial në një periudhë të mëvonëshme. Sot, Malmo është qytet i diturisë, i cili si bazë ka larminë.

Një pjesë e këtij zhvillimi të vazhdueshëm trajtohet edhe në planin shkollor të qytetit të Malmos, i cili është një nga dokumentet bazë të veprimtarisë pedagogjike. Ky plan i përket të gjithë atyre, që janë pjesë e veprimtarisë shkollore, pra, si drejtuesve dhe mësuesve ashtu edhe nxënësve dhe prindërve.

Qyteti i Malmos ka për qëllim, që duke u nisur nga pikësynimet kombëtare, të krijojë një veprimtari pedagogjike, e cila i përshtatet nevojave dhe mundësive të ndryshme të nxënësve. Kjo do të thotë, që përvetësimi i diturisë nga nxënësit ose rezultatet e tyre shkollore të jenë të pavarura si nga faktori ekonomik, etnik dhe kulturor, ashtu edhe nga niveli arsimor i familjes.

Nxënësit duhet të kenë njohuri të mira gjuhësore që të mund të përfitojnë nga mësimi i zhvilluar në shkollë. Kjo është arsyeja, që zhvillimi gjuhësor përbën një nga nocionet kyçe të politikës arsimore të qytetit të

Malmos.

Shkollat e Malmos do të jenë edhe në të ardhmen një vendpunim krijues dhe i sigurtë, i cili do të mundësojë përparimin individual dhe do të favorizojë të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ky mjedis i punës do të krijohet përmes normave dhe rregullave të qarta, si dhe përmes pjesëmarrjes e ndikimit.

Veprimtaria pedagogjike në Malmo duhet të kuptohet gjithashtu si një tërësi. Ajo do të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit midis shkollave dhe formave të ndryshme arsimore, si dhe përmes punës, shoqatave dhe shkollave të larta. Ky bashkëpunim ka për qëllim të inspirojë nxënësit e personelin dhe t'ua bëjë atyre të qarta, qysh në fillim, mundësitë e nxënësve për të zgjedhur në të ardhmen.

Politika arsimore, që qyteti i Malmos ka zgjedhur sot, përcakton nëse fuqia e ardhshme konkurruese e Malmos do të vazhdojë të mbijetojë - në raport me qytete të tjera. Në këtë mënyrë përcaktohet gjithashtu edhe mundësia e krijimit të një mirëqenie për të gjithë.

# Vlerat themelore të shkollës

E gjithë veprimtaria shkollore bazohet në një mori vlerash themelore. Këto janë: demokracia, drejtësia, efektiviteti dhe etika e nëpunësve të shtetit. E gjithë veprimtaria do të mbështetet gjithashtu në konventën e OKB-së për fëmijët, sipas së cilës të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta dhe vlerë të njëjtë.

## **DEMOKRACIA**

Demokraci në shkollë do të thotë midis të tjerash, që:

- të gjithë të njohin të drejtat dhe detyrat e tyre demokratike.
- të gjithëve t'u jepet mundësia e pjesëmarrjes dhe ndikimit në marrjen e vendimeve si për përparimin individual, ashtu edhe për përcaktimin e strukturës shkollore.
- të gjithë të luftojnë mënyrën çenuese dhe diskriminuese të trajtimit të tjetrit.

## **DREJTËSIA**

Drejtësi në shkollë do të thotë, që:

- të njëjtat rregulla themelore të vlejnjë për të gjitha shkollat.
- rregullat e shkollës të zbatohen njëllor për të gjithë.

## **EFEKTIVITETI**

Një shkollë efektive do të thotë, që:

- të gjithë të ndjejnë të njëjtën përgjegjësi për arritjen e qëllimeve të vendosura.
- resurset të përdoren në mënyrë të tillë, që të arrihen qëllimet e vendosura.
- çdo individ i veçantë të ketë mbështetjen e duhur për të arritur sukses në shkollë.

## **ETIKA E NËPUNËSVE TË SHTETIT**

Për personelin e shkollës kjo do të thotë, që:

- të zbatohen vendimet politike.
- të veprojnë në mënyrë krijuese, si për shembull, duke propozuar metoda të reja dhe efektive të punës.
- të ruajnë integritetin e tyre në raport me drejtuesit, politikanët, nxënësit, prindërit dhe të interesuar të tjerë.



*"Në të gjitha komunat duhet të egzistojë një plan mësimor,  
i cili është miratuar nga kuvendi komunal dhe që paraqet  
mënyrën e formimit dhe zhvillimit të sistemit shkollor të  
komunës..."*

*(Ligji për shkollën kap2, §8)*

# Kështu drejtohet shkolla

Veprimtaria pedagogjike rregullohet nëpërmjet dokumenteve të ndryshme drejtuese të formuluar për nivelet kombëtare, komunale dhe ato lokale (shikoni gjithashtu faqen 12).

## **NIVELI KOMBËTAR**

*Parlamenti dhe qeveria:*

- përcakton - nëpërmjet ligjit për shkollën dhe planeve mësimore - qëllimet e përgjithshme të veprimtarisë pedagogjike.
- ka përgjegjësinë e gjithanshme, që shkollimi të ketë të njëjtat vlera në të gjithë vendin.

*Enti për arsim:*

- formulon planin e kurseve, kriteret e notimit, rregulloret dhe këshillat e përgjithëshme.
- siguron arritjen e një cilësie të mirë të arsimit në të gjithë vendin.
- është përgjegjës për kontrollin cilësor nëpërmjet mbikqyrjes, rivlerësimit dhe kontrollit.
- është përgjegjës për problemet e handikapëve brenda kësaj fushe të veprimtarisë.

- ushtron në mënyrë të vazhdueshme kontrollimin e planeve të kurseve dhe kriterëve të notimit.
- është instancë prove për shkollat private nëntëvjeçare dhe të mesme.

*Enti për zhvillimin e arsimit:*

- Mbështet punën e komunës dhe të organeve kompetente në zhvillimin lokal të parashkollës, shkollës dhe arsimit për të rritur.

## **NIVELI KOMUNAL**

*Kuvendi komunal:*

- mban përgjegjësinë kryesore, që shkolla në qytetin e Malmos të zbatojë ligjin për shkollën dhe planet mësimore.
- përcakton planin shkollor të komunës.
- gjatë hartimit të buxhetit, përcakton përparësitë për veprimtarinë pedagogjike.

*Kryesia e komunës:*

- përgjigjet për zbatimin dhe vlerësimin e qëllimeve të vendosura në planin shkollor.

## **NIVELI LOKAL**

*Këshilli i lagjes:*

- ka përgjegjësinë e punës në çerdhe, parashkollore, shkolla 9-vjeçare, shkolla të trajnimit dhe shtëpitë për kalimin e kohës së lirë brenda zonës gjeografike që mbulon.

*Zyra për arsim:*

- ka përgjegjësinë e punës për shkollat e mesme, shkollat e mesme speciale dhe shkollimin për të rritur.

*Këshilli i lagjes dhe zyra për arsim:*

- formulojnë qëllime të përshtatshme në nivel lokal, mbështetur në qëllimet e formuluarat në nivel komunal dhe shtetëror.
- përgjigjen për zbatimin e planit shkollor brenda organizatës së vet.
- përgjigjen për zbatimin dhe analizën vjetore të qëllimeve.

## **NIVELI SHKOLLOR**

Drejtimi shtetëror i shkollës dallon nga veprimtaritë e tjera komunale. Rektori ka përgjegjësi si për zbatimin

e qëllimeve kombëtare, ashtu dhe të atyre komunale. Përgjegjësia e rektorit sanksionohet me ligj dhe quhet "drejtimi i dyfishtë"(shih fq. 13).

*Zona e rektorateve / zonat e veprimt:*

- kanë përgjegjësinë, që të mësuarit të realizohet brenda kuadrit të ditës së përcaktuar shkollore.
- kanë përgjegjësinë për përcaktimin e planeve lokale të punës në mënyrë që të realizohen të gjitha qëllimet.
- ushtron kontroll vjetor të zbatimit të qëllimeve shtetërore, komunale dhe lokale.

*Çerdhja, kopshti, parashkollorja, shkolla 9-vjeçare, shkolla 9-vjeçare speciale, shkolla e trajnimit, shtëpia për kalimin e kohës së lire, shkolla e mesme, shkolla e mesme speciale, shkollimi për të rritur dhe shkolla speciale për të rritur emërtohen në planin shkollor si veprimtari pedagogjike.*

# Shkolla - hap pas hapi

Gjatë veprimtarisë pedagogjike duhet që fëmijët të zhvillohen si individualisht ashtu edhe në grup. Që fëmijëve t'u krijohen premiset më të mira për të ecur përpara në sistemin shkollor, realizohet një bashkëpunim aktiv midis formave të ndryshme shkollore.

## **ÇERDHJA - 1-5 VJEÇ**

Çerdhja është hapi i parë në "rrugën e gjatë të të mësuarit".

Edukimi shoqëror dhe të mësuarit me ëndje është baza për zhvillimin krijues të nxënësve.

Në Malmo ka çerdhe me profile dhe drejtime pedagogjike të ndryshme si edhe çerdhe për fëmijë, që kanë nevojë për ndihmë të veçantë.

## **KOPSHTI PËR FËMIJË - 1-12 VJEÇ**

Kopshti për fëmijë përbën një pjesë të veprimtarisë parashkollore (1-6 vjeç) dhe është një pjesë e kujdesit shkollor për fëmijët (7-12). Kopshti për fëmijë nuk i nënshtrohet planit kombëtar mësimor.

## **PARASHKOLLORJA PËR GJASHTË-VJEÇARËT**

Parashkollorja është ura midis çerddes dhe shkollës.

Pedagogjia e bazuar në lojën, mënyrën krijuese dhe kërkuese të punës përshkon veprimtarinë e parashkollores.


Parashkollorja është e integruar në shkollën e detyrueshme. Ajo drejtohet nga i njëjti rektor.

## **SHKOLLA E DETYRUESHME 7-16 VJEÇ**

Shkolla e detyrueshme përbëhet nga 9-vjeçarja, shkolla speciale 9-vjeçare dhe shkolla e trajnimit.

Ajo karakterizohet nga një mënyrë krijuese dhe kërkuese e punës dhe krijon mundësitë që nxënësit të vazhdojnë studimet në shkollën e mesme.

Shkolla 9-vjeçare speciale dhe ajo e trajnimit pranojnë nxënësit, të cilët për arsye të pengesave në zhvillim nuk mund të arrijnë qëllimet e shkollës 9-vjeçare. Ato drejtohen nga i njëjti rektor, që drejton edhe shkollën 9-vjeçare, në të cilën, ato janë të integruara. Shkallë të ndryshme të integritimit të këtyre veprimtarive janë të pranishme.



*Fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit,  
të cilëve ju ofrohet veprimtari  
pedagogjike, emërtohen në planin  
shkollor si nxënës.*



### **SHTËPIA PËR KALIMIN E KOHËS SË LIRË 7-12 VJEÇ**

Shtëpia e kohës së lirë është një veprimtari, që kujdeset për fëmijët, prindërit e të cilëve punojnë ose studiojnë dhe për këtë arsye kanë nevojë për kujdes jashtë orarit mësimor, si në parashkollore ashtu edhe në shkollë.

Veprimtaria pedagogjike e shtëpisë së kohës së lirë kompletion shkollën 9-vjeçare dhe përqëndrohet në edukimin shoqëror.

Shtëpia e kohës së lirë e ushtron aktivitetin e saj në të njëjtën zonë rektorati si shkolla 9-vjeçare.

### **SHKOLLA E MESME 16-20 VJEÇ**

Shkolla e mesme përgatit nxënësit për punën dhe për jetën dhe vendos bazën për studimet e larta dhe universitare.

Arsimi në Malmo zhvillohet brenda suazave të programeve kombëtare dhe të një numri të madh programesh speciale. Nxënësve, që u mungon kompetenca për të studiuar në programet kombëtare, studiojnë në programin fillestar të veçantë (IVIK) si edhe në programin individual.

Shkolla e mesme speciale është e organizuar si një shkollë më vete dhe ka një rektor të vetin. Megjithatë, disa nga nxënësit e shkollës speciale integrohen në

shkolla të tjera të mesme.

### **SHKOLLIMI PËR TË RRRITUR 20 VJEÇ E LART**

Shkollimi për të rritur është i hapur për të gjithë banorët e rritur të Malmos. Duke patur si pikënisje njohuritë egzistuese të individit si dhe eksperiencën e tij jetësore, shkollimi për të rritur krijon kushte për të mësuar më tej dhe ndihmon në vazhdimin e studimeve të larta, në punë dhe në kualifikimin personal.

Shkollimi për të rritur vlen veçanërisht për ata individë, të cilëve u mungon kompetenca e shkollës së mesme dhe ajo e 9-vjeçares. Përmes të provuarit në mënyrë individuale dokumentohet kompetenca e tyre e fituar jashtë sistemit arsimor suedez.

*Në qytetin e Malmos ka shkolla, të cilat, të vetme, mbulojnë të gjithë qytetin. Disa shembuj të këtyre shkollave janë Shkolla Suedeze e Baletit dhe shkolla internacionale, në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën angleze.*


# Pamja grafike e shkollës

		<b>ORGANIZIMI</b>	
<b>NIVELI KOMBËTAR</b>	PARLAMENTI		
	QEVERIA		
	ENTI PËR ARSIM	ENTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT	
<b>NIVELI KOMUNAL</b>	KUVENDI KOMUNAL		
	KRYESIA E KOMUNES		
<b>NIVELI LOKAL</b>	KËSHILLI I LAGJES	ZYRA PËR ARSIM	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Veprimtaria parashkollore</li> <li>– Shkolla e detyrueshme</li> <li>– Përkujdesja e fëmijëve në shkollë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Shkolla e mesme</li> <li>– Arsimi për të rritur</li> </ul>	
<b>NIVELI SHKOLLOR</b>	ZONA E REKTORATIT	ZONA E REKTORATIT	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Çerdhja</li> <li>– Kopshiti për fëmijë</li> <li>– Shkolla</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Shtëpia për kalimin e kohës së lirë</li> <li>– Shkollat speciale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Shkollat e mesme</li> <li>– Arsimi për të rritur</li> <li>– Arsimit i veçantë për të rritur</li> </ul>

Lexo për organizimin e shkollës në faqen 6.

## DREJTIMI I DYFISHTË

## INFORMIMI PËR CILËSINË



Lexo rreth "drejtimit të dyfishtë" në faqen 7 dhe rreth informimit për cilësinë në faqet 17-21.

# Fushat me përparësi

Analiza, që i është bërë shkollave të Malmos, nxjerr në pah ato pjesë të veprimtarisë, që duhet të zhvillohen, në mënyre që të gjithë nxënësve t'u mundësohet arritja e qëllimeve kombëtare në shkollat përkatëse. Kjo është arsyeja, pse qyteti i Malmos ka zgjedhur të prioritojë katër fusha specifike nga plani shkollor.

Prioritetet tregojnë drejtimin e veprimtarisë pedagogjike dhe mënyrën e konkretizimit të saj. Qëllimi me prioritetet është rritja e numrit të nxënësve të aftë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme.

## ZHVILLIMI GJUHËSOR

Të gjitha studimet flasin mbi rëndësinë e gjuhës për zhvillimin pozitiv të të menduarit, të mësuarit dhe të identitetit të nxënësit. Gjithë puna pedagogjike do të përshkohet nga vetëdija për rëndësinë e gjuhës. Kjo do të thotë që të gjithë mësuesit kanë përgjegjësi për të stimuluar zhvillimin gjuhësor të nxënësit.

Aftësia për të lexuar është themelore që nxënësit të mund të përfitojnë përmbajtjen e librave shkollorë dhe të mediave të tjera, në shkollë. Të gjithë mësuesit, kur bëjnë planifikimin e mësimit duhet të kenë parasysh

aftësinë e të lexuarit të nxënësve.

Shumë nga nxënësit në Malmo kanë të drejtë të studiojnë lëndët "suedishtja si gjuhë e dytë" dhe/ose "gjuha amtare". Qëllimi me këto dy lëndë është që nxënësi të pajiset me dy gjuhë aktive. "Suedishtja si gjuhë e dytë" jep të njëjtën kompetencë si "suedishtja", për studimet e mesme apo ato të larta.

*Qëllime të përgjithshme për "Zhvillimin gjuhësor":*

- Numri i nxënësve, që arrijnë qëllimet në lëndët suedisht, suedisht si gjuhë e dytë dhe gjuhë amtare, duhet të rritet.

## QETËSIA, SIGURIA DHE SHËNDETI

Nxënësve duhet t'u krijohet mundësia që të arrijnë qëllimet e formave të ndryshme shkollore, në një mjedis të qetë dhe të sigurtë. Me norma dhe rregulla të kuptueshme dhe të qarta krijohen kushtet e një bashkekzistence me respekt reciprok.

Ligji për mjedisin e punës duhet të jetë një pjesë e veprimtarisë së përditshme. Ai vlen për të gjitha marrëdhëniet fizike, psikologjike dhe sociale, që kanë të

*Shkolla është një vend pune, prandaj ajo i nënshtrohet Ligjit për ambientin në punë.*

bëjnë me të. Personeli dhe nxënësit kanë përgjegjësi të krijojnë një mjedis të tillë.

Veprimtaria pedagogjike ka një përgjegjësi të veçantë në luftimin e sjelljeve destruktive. Duke u mbështetur në vlerat themelore të shoqërisë demokratike, kjo veprimtari duhet të luftojë vazhdimisht të gjitha format e sjelljeve denigruese, si: armiqësinë ndaj të huajve, racizmin dhe keqtrajtimin.

Në shkollë, nxënësve do t'u jepet mundësia të forcojnë vetëbesimin, duke punuar me ndjenjat e frikës. Puna për krijimin e sigurisë, solidaritetit, mirëkuptimit - dhe rrjedhimisht zvogëlimin të anonimitetit - do të bëhet përmes njësive më të vogla shkollore.

Puna, që stimulon shëndetin me fokus te njeriu në tërësi, duhet të jetë pjesë e veprimtarisë së përditshme.

*Qëllime të përgjithshme për "Qetësinë, sigurinë dhe shëndetin":*

- Më shumë nxënës duhet ta përjetojnë mjedisin shkollor si stimulues, të qetë dhe të sigurtë, të çliruar nga gacimimet dhe sjelljet denigruese.

## **DEMOKRACIA DHE NDIKIMI**

Demokracia dhe ndikimi janë përcaktuese për motivimin, dëshirën për punë dhe përparimin në mësim të nxënësve.

Motivimi dhe dëshira për punë shtohen atëherë kur nxënësi e ndjen veten bashkëkrijues dhe pjesëmarrës në marrjen e vendimeve të rëndësishme. Prandaj, nxënësve dhe prindërve do t'u krijohen mundësi që të ndikojnë në mësim, në mënyrën dhe format e punës si dhe në përmbajtje.

Në veprimtarinë pedagogjike, mësuesit duhet që – nxënësve dhe prindërve – t'ua sqarojnë dhe spjegojnë në mënyrën e mësimdhënies së tyre, si dhe të reflektojnë mbi këtë.

Mësuesit duhet të spjegojnë që, në një shkollë demokratike, individi ka jo vetëm të drejta, por edhe detyra.

*Qëllime të përgjithshme për "Demokracinë dhe ndikimin":*

- Më shumë nxënës duhet ta përjetojnë ndikimin dhe pjesëmarrjen në punën e përditshme në shkollë.

### **PUNA NDËRKULTURORE**

Puna ndërkulturore ka të bëjë me të mësuarit që – gjatë takimeve – të tregohet respekt reciprok për dallimet dhe ngjashmëritë e njëri-tjetrit. Dallimet ndërmjet njerëzve duhet të paraqesin një pasuri dhe një mundësi në veprimtarinë pedagogjike.

Mënyrat e ndryshme kulturore të të shprehurit janë të rëndësishme dhe do të jenë një pjesë e veprimtarisë pedagogjike për të stimuluar të përvetësuarit e mësimit, për të përmirësuar bashkekzistencën dhe për të forcuar mirkuptimin midis kulturave të ndryshme. Kontakti me shoqërinë që na rrethon duhet të pasurojë edhe më tej të mësuarit. Prandaj, është e rëndësishme që të mbahet kontakt i ngushtë me jetën ekonomike, shoqatat dhe veprimtari të tjera.

*Qëllime të përgjithshme për "Punën ndërkulturore":*

- Më shumë nxënës duhet të përjetojnë që larmia, e parë nga këndvështrime të ndryshme, shihet si një pasuri në shkollë.



# Mbikqyrja

Plani shkollor përbën një pjesë të rëndësishme për zhvillimin cilësor pedagogjik në qytetin e Malmos. Puna cilësore përfshin caktimin e qëllimeve të qarta, zhvillimin e metodave zbatimore si edhe informimin e komunikimin e rezultatit për të gjitha nivelet.

## **QËLLIMET KOMBËTARE**

*Shembuj të qëllimeve kombëtare, që përfshihen në "drejtimin e dyfishtë":*

- Nxënësit duhet të kenë të paktën notë kaluese në suedisht/suedisht si gjuhë e dytë, matematikë dhe anglisht për të studiuar në një program kombëtar në shkollën e mesme. (Ligji për shkollën - kap.5 §5)
- Nxënësi do të marrë dëftesë përfundimtare kur ai përfundon studimet në një program kombëtar ose të veçantë dhe merr vlerësimin (IG-MVG) në të gjitha kurset dhe projektet e tij shkollore. (Rregullorja për shkollat e mesme - kap.7 §8)

*Nga plani i veprimit "Mirëqënie për të gjithë": Qëllimi afatgjatë është që të gjithë nxënësit të jenë kompetentë për të studiuar në shkollat e mesme me program kombëtar. Qëllimi afatshkurtër është që brenda vitit 2008 numri i nxënësve jo kompetentë për studim të mëtejshëm, të mos e kalojë mesataren e vendit.*

## **QËLLIME KOMUNALE BRENDË FUSHAVE ME PËRPARËSI**

Brenda fushave me përparësi paraqiten dy qëllime; drejtimin, që tregon kahjen afatgjate dhe rezultatit, që matet çdo vit (shih faqen në vijim)

Më pas, qëllimet brenda fushave prioritare përshtaten - në planet lokale të punës brenda zonave respektive të rektoratit – dhe kthehen në qëllime operative.

# Qëllime në fushat me përparësi

## QËLLIMET NË DREJTIM

<b>ZHVILLIMI GJUHËSOR</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>– Zhvillimi gjuhësor i nxënësve duhet të jetë në qendër të të gjitha formave shkollore.</li><li>– Duhet t'i kushtohet vëmendje rëndësishme të lexuarit për zhvillimin gjuhësor dhe personal.</li><li>– Fëmijët me prejardhje të huaja duhet të kenë mundësi të zhvillojnë dygjuhësinë aktive.</li></ul>
<b>QETËSIA, SIGURIA DHE SHËNDETI</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>– Mjedisi shkollor duhet të jetë i qetë dhe i sigurtë si për nxënësit, ashtu dhe për personelin.</li><li>– Mjedisi shkollor duhet të stimulojë zhvillimin fizik dhe psiko-social si të nxënësit, ashtu dhe të personelit.</li></ul>
<b>DEMOKRACIA DHE NDIKIMI</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>– Nxënësit duhet të kenë një përgjegjësi edhe më të madhe në përvetësimin e mësimin gjatë kohës së shkollës.</li><li>– Pjesëmarrja në veprimtaritë pedagogjike të qytetit të Malmos duhet të jetë argëtuese dhe stimuluese.</li><li>– Ndikimi i nxënësve dhe prindërve duhet të forcohet.</li></ul>
<b>PUNA NDËRKUL- TURE</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>– Veprimtaria duhet karakterizuar nga perespektiva ndërkulturore.</li><li>– Dita e punës do të përshkohet nga larmia etnike dhe kulturore e nxënësve.</li></ul>

### QËLLIMET NË REZULTAT

<b>ZHVILLIMI GJUHËSOR</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Të gjithë mësuesit duhet të punojnë me zhvillimin gjuhësor të nxënësve.</li> <li>– Të gjithë nxënësit duhet të kenë mundësi të vizitojnë bibliotekën e shkollës dhe atë popullore.</li> <li>– Të gjithë nxënësve duhet t'u ofrohet mësimi/ushtrimi i gjuhës amëtare (udhëzimi dhe zgjedhja e gjuhës) dhe gjuhës suedeze si gjuhë e dytë.</li> </ul>
<b>QETËSIA, SIGURIA DHE SHËNDETI</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– I gjithë personeli dhe të gjithë nxënësit, duhet të dinë se si realizohen planet e hartuara për punën me mjedisin punues dhe për punën kundër cënimit personal, kërcënimit dhe dhunës.</li> <li>– I gjithë personeli dhe të gjithë nxënësit duhet ta ndjejnë veten mirë në mjediset e shkollës.</li> <li>– Bashkëpunimi me qendrat e kujdesit të individit dhe të familjes dhe qendrave parandaluese, duhet të rritet.</li> </ul>
<b>DEMOKRACIA DHE NDIKIMI</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Të gjithë nxënësve duhet t'u bëhen të ditura qëllimet për arritjen e njohurive.</li> <li>– Numri i nxënësve të kënaqur duhet të rritet.</li> <li>– Numri i nxënësve dhe prindërve, që e ndjejnë se kanë ndikim në shkollë, duhet të rritet.</li> <li>– Numri i nxënësve, që marrin pjesë në këshilla/ kryesi të nxënësve ose në veprimtarinë e përfaqësuesve mbrojtës duhet të rritet.</li> </ul>
<b>PUNA NDËRKULTURORE</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Çdo shkollë në Malmo duhet të rrisë më tej bashkëpunimin me shkollat dhe format shkollore të tjera të qytetit.</li> <li>– Më shumë nxënës duhet ta ndjejnë se kanë mundësi të njëjta në shkollë, pavarësisht nga prejardhja e tyre.</li> </ul>

*I gjithë personeli pedagogjik  
emërtohet në planin  
shkollor si mësues.*



## **KONTROLLI**

Për të dhënë një pamje të përmbledhur të veprimtarisë përdoren metoda të ndryshme kontrolli. Ato janë të dokumentuara në dy plane të cilësisë; një për sistemin shkollor të detyruar dhe një për shkollimin e mesëm dhe për të rritur.

Kontrolli vjetor duhet të realizohet, si më poshtë:

- notim si dhe provim kombëtar në suedisht, matematikë dhe anglisht.
- mënyra se si nxënësit dhe prindërit e përjetojnë funksionimin e veprimtarisë në raport me qëllimet dhe direktivat e dhëna në planin shkollor.
- mënyra se si nxënësit e përjetojnë situatën në shkollë.

## **INFORMIMI DHE RAPORTIMI**

Çdo shkollë dhe komunë duhet të bëjë raportin vjetor të rezultateve të arritura. Kjo është një kërkesë ligjore për shkollat 9-vjeçare, të mesme dhe të të rriturve. Parashkollorja duhet gjithashtu të informojë për rezultatet e saj.

Informimi për cilësinë duhet të përmbajë:

- një informim të prioriteteve të shkollës në fushën e qëllimeve kombëtare dhe komunale.
- një vlerësim, që tregon nivelin e arritur të qëllimeve.
- një përshkrim të masave që do të merren, në rast se qëllimet nuk janë arritur.

Rezultatet do të raportohen në të gjitha nivelet komunale (shih faqen. 13). Rezultatet e arritura pedagogjike krijojnë bazën për vendimet e ardhëshme, në punën për zhvillimin e mëtejshëm.

Prindërve dhe personave të interesuar do t'ju jepet informacion për rezultatin e punës cilësore në shkollat e Malmos, kur raporti i cilësisë të jetë përfunduar.



# Nëse dëshironi të dini më shumë

## **PLANI SHKOLLOR PËR MALMON**

[www.malmo.se](http://www.malmo.se)

## **KONVENTA E FËMIJËVE DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE**

[www.bo.se](http://www.bo.se)

## **ENTI PËR ARSIM**

[www.skolverket.se](http://www.skolverket.se)

## **ENTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

[www.skolutveckling.seu](http://www.skolutveckling.seu)

## **LIGJI PËR MJEDISIN E PUNËS**

[www.av.se/skola](http://www.av.se/skola)

## **NËSE DËSHIRONI TË DINI MË SHUMË RRETH SHKOLLËS TUAJ – KONTAKTONI REKTORIN TUAJ.**

Hyni në [www.malmo.se](http://www.malmo.se) ose telefononi në çentralin e komunës së Malmos: 040-34 10 00.

**MALMÖ STAD**

August Palms plats 1

Stadskontoret

205 80 Malmö

tel 040-34 10 00

[www.malmo.se](http://www.malmo.se)